



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 219, datë 27.10.2021**

**MBI**

**SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT NË LIDHJE ME PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË VENDIMIT NR. 110, DATË 26.04.2021, NGA SHOQËRIA “BIOPOWER GREEN ENERGY” SH.P.K., VENDIMIT 111, DATË 26.04.2021, NGA SHOQËRIA “E-VENTO S.R.L. ALBANIA” SH.P.K., SI DHE VENDIMIT NR. 112, DATË 26.04.2021, NGA SHOQËRIA “HERA” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 136/6 prot., datë 25.10.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi plotësimin e kushteve të vendimit nr. 110, datë 26.04.2021, nga shoqëria “BIOPOWER GREEN ENERGY” sh.p.k., vendimit nr. 111, datë 26.04.2021, nga shoqëria “E-VENTO srl ALBANIA” sh.p.k., dhe vendimit nr. 112, datë 26.04.2021, nga shoqëria “HERA” sh.p.k.”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimet nr. 110, nr. 111 dhe nr.112, të datës 26.04.2021, ka vendosur që shoqëritë, përkatësisht “BIOPOWER GREEN ENERGY” shpk, “E-VENTO s.r.l ALBANIA” shpk dhe “HERA” shpk duhet të depozitonin në ERE, brenda 3 muajve nga botimi në Fletoren Zyrtare i këtyre vendimeve, dokumentacion në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimeve të licencimit të këtyre shoqërive e po ashtu dokumentacionin ligjor vërtetues për realizimin e investimeve në kuadër të zhvillimit të projekteve eolike.
- Në zbatim këtyre vendimeve, shoqëritë kanë përcjellë në ERE informacion dhe dokumentacion brenda afatit.
- Nga shqyrtimi këtij dokumentacioni, rezultoi se shoqëritë kishin referuar se ishin në proces për t’u pajisur me dokumentacione përkatëse nga organe të tjera të shtetërore, sic janë bashkitë në lidhje me dokumentet e pronësisë dhe Agjencia Kombëtare të Mjedisit për lejen mjedisore etj.
- ERE iu drejtua organeve kompetente për të marrë një informacion të saktë se në cilën fazë ndodhet pajisja me këto dokumente apo leje.

- Pas marrjes së përgjigjes nga disa prej këtyre organeve, u depozitua dhe materiali përkatës në lidhje me plotësimin nga ana e shoqërive të kushteve të vendosura në vendimet e Bordit nr. 110/2021, nr. 111/2021 dhe nr. 112/2021.
- Pas depozitimit të këtij materiali për shqyrtim, është përcjellë në ERE informacion dhe dokumentacion shtesë për sa kërkuar më herët nga ERE.
- Në mbështetje të nenit 67 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, me qëllim shqyrtimin e këtij dokumentacioni dhe zhvillimin e seancave të mundshme dëgjimore, vlerësohet e arsyeshme me shtyrja me 30 ditë pune vendimmarrja e Bordit të ERE-s, Bordit të ERE-s në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimeve të Bordit nr. 110, datë 26.04.2021, nr. 111, datë 26.04.2021 dhe nr. 112, datë 26.04.2021.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e Bordit të ERE-s në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimeve të Bordit nr. 110, datë 26.04.2021, nr. 111, datë 26.04.2021 dhe nr. 112, datë 26.04.2021.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.